

**AKT THEMELIMI
SHOQËRIA TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ANIFARMA SHPK”**

Sot në Tiranë, më 13.03.2024, bazuar në legjislacionin shqiptar, me vullnetin tim të lirë, jam shprehur në nënshkrimin si ortak themelues dhe deklaroj se kam përpiluar si më poshtë Aktin e Themelimit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar **“ANIFARMA SHPK”**.

Unë ortaku i vetëm Anatas HASIMAJ, i datëlindjes 28.10.1978, i identifikuar nëpërmjet letërnjoftimin me numër personal H81028071H, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar:

THEMELIMI

Neni 1

Themelohet Shoqëria tregtare “ANIFARMA SHPK”, e cila do ti nënshtronhet legjislacionit të Republikës së Shqipërisë në fuqi. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij Akti Themelimi dhe Statutit të Shoqërisë.

SELIA E SHOQËRISË

Neni 2

Selia e shoqërisë tregtare “ANIFARMA SHPK” do të jetë në adresën: Lagjja Unaza e Re, Rruga Sabri Preveza, Kompleksi GORA+JON, Kulla 6, Shkalla 2, Kati perdhe, TIRANË.

Neni 3

Shoqëria tregtare mund ta ushtrojë veprimtarinë e saj në të gjithë juridiksionin territorial të Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë Shtetit.

Shoqëria mund të krijojë seli, filiale, agjensi dhe përfaqësi si në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë saj.

Njësitetë varëse të shoqërisë jashtë shtetit do të krijohen nëse kjo e drejtë parashikohet dhe lejohet nga legjislacioni i vendeve të huaja, normat e së drejtës ndërkombëtare dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.

OBJEKTI I SHOQËRISË

Neni 4

Shoqëria tregtare krijohet për të ushtruar Aktivitetin e saj tregtar me objekt: Import-eksport, tregti me pakicë dhe shumicë të artikujve të parfumerisë, suplementeve ushqimore dhe produkteve kozmetike. Tregtim të produkteve parafarmaceutike, paisjeve mjekësore, të aparaturave spitalore, detergjentë të ndryshem, produkte dizinfektuese, kite laboratorike, produkte dentare, suplemente të lëngshme e të ngurta, si dhe cdo produkt tjeter mjekesore dhe farmaceutike.

Neni 5

Me vendim të organeve vendimarrëse të shoqërisë, Shoqëria mund të zgjerojë aktivitetin e saj tregtar edhe në drejtime të tjera, kur ato janë në interes së mbarëvajtjes së aktivitetit të shoqërisë.

KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 6

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 (Njëqindmijë lekë), kapital i cili formohet dhe do të jetë në vlerë monetare. Shuma e kapitalit themeltar do të depozitohet në një llogari bankare në emër të shoqërisë në një prej bankave të nivelit të dytë që zhvillojnë aktivitetin në Republikën e Shqipërisë

KOHEZGJATJA E SHOQËRISË

Neni 7



Kohëzgjatja e ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë është pa afat dhe fillon nga data e regjistrimit të saj si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakut të Vetëm ka të drejtë të ndryshojë me vendim kohëzgjatjen e ushtrimit të veprimtarisë dhe ky vendim depozitohet menjëherë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit

DREJTIMI I SHOQËRISË

Neni 8

Veprimtaria e shoqërisë tregtare "ANIFARMA SHPK" do të drejtohet nga Administratori i saj z. Anastas HASIMAJ për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjedhje.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakut të Vetëm ka të drejtë të emerojë një administrator tjetër, nëse e gykon të nevojshme.

Neni 9

Administratori i shoqërisë ka të drejtë të punësojë persona të ndryshëm në funksion të zhvillimit të veprimtarisë së shoqërisë

Neni 10

Shoqëria tregtare "ANIFARMA SHPK" do të ketë vulën e saj, në të cilën shkruhet emërtimi i shoqërisë.

Neni 11

Shoqëria tregtare "ANIFARMA SHPK" deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me kërkesat e legjisacionit shqiptar në fuqi.

Ky akt themelimi u përpilua në gjuhën shqipe dhe miratohet prej Ortakut të Vetëm duke u nënshkruar si më poshtë:

THEMELUESI I SHOQËRISË TREGTARE

"ANIFARMA SHPK"

ORTAKU I VETËM

Anastas HASIMAJ

